



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



**RAPORT MONITORIMI  
E DREJTA E INFORMIMIT DHE E KONSULTIMIT  
DHE  
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

## PASQYRA E LËNDËS

|  |    |
|--|----|
| LISTA E SHKURTIMEVE.....   | 1  |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....  | 2  |
| I. HYRJE.....  | 3  |
| II. METODOLOGJIA.....  | 7  |
| III. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR .....  | 12 |
| IV. LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE AFTËSIA E KUFIZUAR .....                           | 15 |
| V. ZBATIMI I LEGJISLACIONIT MBI TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE KOMUNITETI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR..... | 19 |
| VI. REKOMANDIME & KONKLUZIONE.....   | 23 |

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

|       |  |
|-------|--|
| DUDNJ | Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut                                |
| KDPAK | Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara                   |
| KEDNJ | Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut                                  |
| KNDCP | Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike                    |
| KDI   | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale |
| VKM   | Vendim i Këshillit të Ministrave   |

## I HYRJJE

Komunikimi dhe informimi janë dy faktorë thelbësorë për zhvillimin e shoqërive. Komunikimi dhe aksesimi në informacion krijojnë lidhjet e domosdoshme ndërmjet anëtarëve të një shoqërie dhe vetëm në këtë mënyrë kjo e fundit është në gjendje që të të përparojë dhe të lejojë zhvillimin personal të gjithësecilit prej anëtarëve të saj.<sup>1</sup> Duke pasur këtë parasysh, një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar produkteve dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Sa më shumë shoqëri totalitare dhe represive, aq më i kufizuar është aksesimi në informacion dhe për rrjedhojë kufizohen të drejta të tilla si ajo e lirisë së shprehjes dhe mendimit. Për më tepër, kjo theksohet kur produktet dhe shërbimet për komunitete të caktuara janë të pakta dhe të pamjaftueshme. Kur një shoqëri respekton të drejtat e njeriut, pjestarët e saj shfaqin më shumë solidaritet kundrejt njeri tjetrit dhe janë më të predispozuar për të shkëmbyer informacion dhe për të punuar së bashku. Si pasojë, është e mundur që të ndërtohen shoqëri më gjithëpërfshirëse, ku të gjithë përfshihen në të gjitha sferat e jetës dhe ku personat me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë në kushte të barabarta më pjestarët e tjerë.<sup>2</sup>

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) ishte një hap themelor për zbatimin e standardeve të të drejtave të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. KDKPAK përcakton të drejtat civile, politike, sociale, ekonomike dhe kulturore, duke i risjellë ato në kontekstin e parimeve themelore për personat me aftësi të kufizuara, siç janë aksesimi dhe përfshirja.<sup>3</sup>

KDKPAK e miratuar në vitin 2006 dhe e ratifikuar nga shteti Shqiptar në vitin 2012, ka nxitur shtetet, duke përfshirë shtetin Shqiptar për të prioritetizuar dhe për të përfshirë aftësinë e kufizuar në programet e tij.

---

<sup>1</sup>Rrugë të reja për fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara përmes aksesit në informacion dhe njohuri me teknologji të informacionit, UNESCO, Shkurt, 2013.

<http://www.unesco.org/neë/en/communication-and-information/resources/publications-and-communication-materials/publications/full-list/unesco-global-report-opening-neë-avenues-for-empowerment-icts-to-access-information-and-knowledge-for-persons-with-disabilities/>

<sup>2</sup>Idem.

<sup>3</sup> Raport kombëtar: Aftësia e kufizuar dhe aksesimi në informacion; Article19 Free Word Centre, Liban, Maj, 2015  
<https://www.article19.org/resources.php/resource/37983/en/lebanon:-disability-and-access-to-information>

Në rastin e personave me aftësi të kufizuara, zbatimi i të drejtës për informim dhe konsultim është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me aksesueshmërinë. Pa aksesueshmëri, qartësisht, personat me aftësi të kufizuara nuk mund të realizojnë të drejtën e tyre për t'u informuar dhe konsultuar. Nëse një institucion i cili është i paaksesueshëm, e ka të vështirë që të përfshijë komunitetin e personave me aftësi të kufizuara në proceset e informimit dhe konsultimit. Mungesa e aksesueshmërisë fizike, asaj në teknologji apo dhe mungesa e aksesueshmërisë në procedura e bazë materiale, bën që personat me aftësi të kufizuara ta kenë të pamundur të jenë të pranishëm në aktivitetet që zhvillohen dhe të marrin pjesë në mënyrë efektive.

Pa akses në informacion, personat me aftësi të kufizuara nuk mund të punojnë për adresimin e pengesave që hasin në arsim, punësim, transport dhe shëndetësi.

Një numër i konsiderueshëm i të rriturve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara jetojnë në institucione rezidenciale që i izolojnë ata edhe më shumë nga jeta e përditshme. Mungesa e aksesit në informacion përforcon këtë izolim apo përjashtim, duke rënë ndesh me parime themelore, siç janë përfshirja dhe pjesëmarrja.<sup>4</sup>

Akresi në informacion për personat me aftësi të kufizuara është thelbësor, jo vetëm sepse bën shoqërinë gjithëpërfshirëse por edhe sepse i jep instrumentet e domosdoshme komunitetit të personave me aftësitë kufizuara për të kërkuar respektimin e të drejtave të tyre dhe për të vendosur sipas rastit para përgjegjësisë institucionet shtetërore përgjegjëse.

Por personat me aftësi të kufizuara nuk janë në gjendje të kërkojnë, të shkëmbejnë dhe të marrin informacionin e kërkuar ose të kenë mundësinë ta përdorin atë për të ndryshuar apo përmirësuar jetën e tyre. Shpeshherë informacioni që kërkohet nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara nuk është i aksesueshëm.

Informacion i aksesueshëm është informacioni që paraqitet në formate të kuptueshme për personat me aftësi të kufizuara të të gjitha llojeve. Përveç formateve Braille, shkronjave të zmadhuara, përdorimit të titrave, nevojiten edhe formate sa më të thjeshtuara. Si shembull, personat me aftësi të kufizuara mendore mund të kenë nevojë për shumë mbështetje në situatat kur diskutohet heqja e zotësisë së tyre për të vepruar për shkak të aftësisë së kufizuar në mënyrë që të kenë shumë informacion, në mënyrë të kuptueshme që të drejtat, vullneti dhe preferencat e tyre të respektohen nga të tjerët. KDKPAK thekson se aftësia e kufizuar nuk duhet të përbëjë

---

<sup>4</sup>Idem.

pengesë për të ushtruar të drejtat në kushte të barabarta me të tjerët. Që kjo të ndodhë, informacioni duhet të paraqitet në formate të arritshme dhe të kuptueshme edhe në situata komplekse dhe të vështira.<sup>5</sup>

Përveç rasteve kur informacioni nuk është i aksesueshëm ose institucionet nuk janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, ndodh shpeshherë që informacioni nuk mbledhet nga ana e institucioneve përgjegjëse në mënyrë të rregullt. Pavarësisht faktit që në Shqipëri, ka njohur përmirësime të dukshme në hartimin e një legjislacioni në përputhje me standardet ndërkombëtare, ai nuk zbatohet e për pasojë shpeshherë komuniteti i personave me aftësi të kufizuara nuk ka informacionin e nevojshëm për të ndikuar në politika apo për të vënë para përgjegjësitë institucionet shtetërore.

Konsultimi nga ana tjetër ka të bëjë me përfshirjen e njerëzve të prekur nga çështje apo vendime të caktuara, duke i pyetur për nevojat e tyre, duke dëgjuar pikëpamjet e tyre dhe duke iu komunikuar atyre që janë përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në rezultatet e këtij procesi. Konsultimi ndihmon në planifikimin, shpërndarjen dhe monitorimin e shërbimeve dhe produkteve më të mira. Konsultimi duhet të bëhet pjesë e praktikave më të mira. Ai duhet të jetë sistematik dhe jo vetëm një ngjarje që ndodh herë pas here.<sup>6</sup>

Mesazhi thelbësor është se cilido qoftë qëllimi i konsultimit, qoftë për të identifikuar nevojat, për të zhvilluar politika, strategji apo plane, produkte të reja ose shërbimet, ka mënyra dhe mjete të thjeshta për të siguruar një proces konsultimit të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara.<sup>7</sup>

Ky raport ka si qëllim kryesor të evidentojë nivelin e njohjes dhe përdorimit të instrumenteve ligjore të ofruar nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar nga ana e personave me aftësi të kufizuara për të ushtruar të drejtën për t'u informuar dhe konsultuar.

---

<sup>5</sup>Udhëzim për mënyrat efektive të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, National Disability Authority, 2002 <http://nda.ie/nda-files/-Ask-Me-Guidelines-for-Effective-Consultation-with-People-with-Disabilities1.pdf>

<sup>6</sup>Integrimi aftësisë së kufiuar: Këshilla praktike, APPEAR, Austri. [https://appear.at/fileadmin/Dokumente/appear.at/application/guidelines\\_strategies/disability\\_mainstreaming\\_appear.pdf](https://appear.at/fileadmin/Dokumente/appear.at/application/guidelines_strategies/disability_mainstreaming_appear.pdf)

<sup>7</sup>Manual për stafin e Bashkimit Europian: Zhvillimi i programeve gjithëpërfshirëse për aftësinë e kufiuar [https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/guide-disability-inclusive-development-cooperation-2012\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/guide-disability-inclusive-development-cooperation-2012_en.pdf)

Një tjetër qëllim është ai i ndërgjegjësimit të institucioneve shtetërore dhe sjelljen e vëmendjes së tyre në rëndësinë themelore që kanë e drejta e informimit dhe konsultimit publik për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara. Ky qëllim mendohet të arrihet përmes monitorimit të vazhdueshëm të institucioneve dhe diskutimit të rezultatet të arritura, me qëllim gjetjen e rrugëve apo mënyrave të bashkëpunimit.

## **METODOLOGJIA**

Me qëllim përmbushjen e objektivave të mësipërme u përzgjedh një metodë sasiore. Të dhënat u mblodhën duke përdoruar alternimin e të dhënave sasiore me të dhëna sekondare të përftuara nga disa burime.

Të dhënat sekondare u mblodhën përmes rishikimit të literaturës ekzistuese, dokumentave ligjore dhe politikë, kombëtare e ndërkombëtare mbi të drejtën e informimit dhe konsultimit të personave me aftësi të kufizuara.

Rishikimi i literaturës pati për qëllim që të identifikojë kuadrin ligjor, si dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me të drejtën e informimit dhe konsultimit publik të personave me aftësi të kufizuara. Bazuar në sa më sipër, rishikimi i literaturës u fokusua në shqyrtimin e kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar duke u përqëndruar në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ligjin për të Drejtën e Informimit dhe Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Një pjesë e rëndësishme e literaturës ishin dhe raportet kombëtare mbi zbatimin e legjislacionit.

Këto të dhëna, të cilat u mblodhën gjatë fazës së parë të monitorimit shërbyen për realizimin e instrumenteve të mbledhjes së të dhënave sasiore gjatë intervistimeve të zhvilluara në fazën e dytë të monitorimit. U përgatitën dy pyetësorë për personat me aftësi të kufizuara me të cilët u zhvilluan intervista në rajonet e Tiranës, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës. Në total gjatë zhvillimit të monitorimit u zhvilluan 110 intervista me persona me aftësi të kufizuara. Personat u përzgjedhën në mënyrë tillë që të përfaqësonin të gjitha grupimet dhe llojet e aftësisë së kufizuar. U zhvillua gjithashtu një intervistë me përfaqësues të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale dhe të Drejtën e Informimit e cila kishte për qëllim mbledhjen e informacionit mbi masat e marra nga ana e tyre për zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe Njoftimit e Konsultimit Publik në kontekstin e personave me aftësi të Kufizuara. Duke pasur në vëmendje, që realizimi i dy të drejtave kaq themelore, siç janë, e drejta për informim dhe për konsultim është i lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me realizimin e të drejtës për aksesueshmëri, gjatë intervistës u morën të dhëna për zbatimin e VKM-së Nr. 1074, datë



23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.

Personat me aftësi të kufizuara u kontaktuan në mënyrë elektronike dhe përmes telefonit për t'i kthyer përgjigje pyetjeve të përfshira në pyetësorët e realizuar. Duhet theksuar që një pjesë e personave me aftësi të kufizuara të kontaktuar nuk kthyen përgjigje brenda afatit të caktuar ose përgjigjet e dhëna ishin të pjesshme. Një pjesë e tyre nuk kishte informacion të mjaftueshëm në lidhje me përmbajtjen e dy ligjeve kryesore të sipërpërmendura, objekt i këtij monitorimi.

Mbledhja e të dhënave për realizimin e këtij raporti u krye gjatë periudhës Korrik- Shtator 2017.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga të dhënat e përftuara rezulton që komuniteti i personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri ka informacion të paktë e të pamjaftueshëm mbi Ligjin për të Drejtën e Informimit dhe të Konsultimit Publik. Shumica e personave të intervistuar deklaroi që nuk i njeh ligjet dhe nuk ka shfrytëzuar mekanizmat që ato ofrojnë. Në Shqipëri personat me aftësi të kufizuara akoma nuk vetëpërfaqësohen në institucionet publike. Janë të afërm të tyre të cilët i përfaqësojnë ato për çështjet ligjore apo administrative. Por edhe në këto raste të përfaqësimit, të afërmit apo familjarët nuk e njohin legjislacionin. Një numër shumë i vogël personash pohon që i është drejtuar me letra apo e-maile në rrugë zyrtare autoriteteve publike. Personat pohojnë që rruga më shkurtër dhe më e shpejtë është ajo e kontaktimit të drejtëpërdrejtë përmes palëve të treta me punonjës të administratës publike, prandaj deklarojnë që informacionin shpeshherë e marrin në rrugë joformale apo jozyrtare. Edhe nga ky numër i vogël, nuk kanë marrë përgjigje. Në asnjë prej rasteve përgjigjet nuk kanë qënë në formate të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Këtu marrim shkas, t'i referohemi edhe raportit të monitorimit të realizuar nga FSHDPAK “Zbatimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara”, nga i cili rezultoi që ka një nivel të ulët të zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*. Ky vendim, ndër të tjera rregullon pikërisht edhe aksesin në informacion apo në proceset e konsultimit.

Në asnjë nga rastet kur personat i janë drejtuar institucioneve publike për informacion apo për konsultim, nuk kanë kërkuar formate apo aksesueshmëri për aftësinë e kufizuar. Kjo pasi, komuniteti i personave me aftësi të kufizuara nuk e njeh mjaftueshëm vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.

Vetëm në tre raste personat me aftësi të kufizuara janë drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personave dhe të Drejtës së Informimit.

Vetëm në tre raste ata njihnin koordinatorët për të drejtën e informimit në institucionet me të cilët kanë ndërvepruar ata apo të afërm të tyre.

Personat me aftësi të kufizuara nuk përdorin programet e transparencës (kryesisht faqet e internetit të institucioneve) për të marrë informacionin që kërkonin. Në këto raste kanë deklaruar që kanë hasur vështirësi me gjetjen e informacionit në faqet e internetit.

Nga njëra anë konstatohet një nivel i ulët të njohjes së të drejtave që burojnë nga ligjit për të drejtën e informimit dhe të konsultimit publik, e për rrjedhojë mospërdorim i mjeteve që ofrojnë këto dy ligje. Ndërsa nga ana tjetër, janë autoritetet shtetërore të cilat nuk zbatojnë në mënyrë të plotë detyrimet që i janë vendosur atyre nga legjislacioni për aksesueshmërinë.

Përsa i përket Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, konstatohet, që edhe pse ky ligj është miratuar në të njëjtën kohë me ligjin e ri për informimin, njihet më pak nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

Një numër shumë i ulët ka marrë pjesë në konsultime publike të zhvilluara në nivel lokal dhe qendror. Ata janë ftuar në konsultim pas hartimit të një projekt akti apo vendimit. Njoftimin kryesisht personat e kanë marrë në formatin elektronik.

Personat shprehen që kanë dhënë rekomandime në formë zyrtare por në shumë pak raste. Ata pohojnë që gjithmonë kanë pasur probleme me kohën e vendosur në dispozicion të tyre, përsa i përket afateve të njoftimit por edhe kohën për hartimin e rekomandimeve. Në të gjitha rastet konstatohet që aksesueshmëria ka qënë e munguar për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara. Megjithatë pranojnë që ka pasur përmirësime në drejtim të garantimit të saj, ata pohojnë që nuk zbatohen standardet dhe aksesueshmëria është gjithmonë e pjesshme dhe kjo ka çënuar pjesëmarrjen e tyre në proceset e konsultimit.

Në lidhje me procedurat e ndjekura në rastet kur rekomandimet e tyre nuk janë marrë parasysht nga institucionet, në asnjë rast ata nuk kanë ndjekur procedurën e parashikuar në Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe deklarohet që nuk kanë marrë sqarime mbi arsyet e refuzimit të rekomandimeve ose mospërfshirjes së tyre në projektet përfundimtare.

Nga analiza e dy ligjeve kryesore, ai i informimit dhe konsultimit publik, rezulton që ato janë ligje të cilat nuk përfshijnë personat me aftësi të kufizuara. Sigurisht, që duke u bazuar në parimet e përgjithshme, siç është ai mosdiskriminimit apo gjithëpërfshirjes, parime të cilat gjenden në të dyja ligjet, përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuara por niveli i mbrojtjes

dhe përfshirjes së tyre vetëm duke u bazuar mbi këto parime të përgjithshme rezulton të jetë i pamjaftueshëm. Një nga rekomandimet kryesore, është që gjatë ndërhyrjeve të mundshme në këto dy ligje, të përfshihen shprehimisht edhe koncepte si aksesueshmëria, përshtatja e arsyeshme apo personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Legjislacioni i cili garanton aksesueshmërimë është një legjislacion i plotë dhe i avancuar, i cili natyrshëm zbatohet edhe në të drejtën e informimit dhe konsultimit publik. Nevojitet që autoritetet publike përgjegjëse për dhënien e informacionit t'i referohen në mënyrë të vazhdueshme këtij legjislacioni. Ndërhyrjet legjislative të përmendura më sipër në kuadrin e rekomandimeve, mund të realizohen edhe përmes referimit në legjislacionin mbi aksesueshmërisë në dy ligjet e mësipërme. Në çdo rast është e domosdoshme që autoritetet publike, përveç njohjes së ligjeve të përgjithshme të njohin dhe të zbatojnë legjislacionin e posaçëm që rregullon aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

Rezultoni nga ky monitorim që institucioni i KMD edhe pse kishte marrë disa masa lehtësuese në lidhje me përjashtimin e personave me aftësi të kufizuara nga tarifa të vendosura në këtë institucion, vendimi për aksesueshmërinë nuk njihej.

Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara ka nevojë për trajnime në lidhje me legjislacionin dhe nxitje të vazhdueshme për të përdorur mekanizmat ligjore ekzistuese. Mungesa e njohurive e alternuar me mungesën e aksesueshmërisë drejton personat në kërkimin e informacioni në rrugë jozyrtare duke shmangur rruget e parashikuara në ligj. Nga ana tjetër, këto mungesa, sikurse u theksua më lart, përjashtojnë nga proceset e konsultimit personat me aftësi të kufizuara.

### III. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR

E drejta për informim është një e drejtë tashmë e mirëkonsoliduar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në nivel kombëtar, e gjejmë në mënyrë tipike në ligjet kushtetuese të shumë vendeve pas viteve 1990 dhe gjithashtu në ligjet që trajtojnë në mënyrë të posaçme të drejtën e informimit. Ndërsa në nivel ndërkombëtar, të drejtën për informim e gjejmë në një numër të madh dokumentesh apo traktatesh ndërkombëtare.<sup>8</sup> E drejta e informimit është bazuar ose gjendet nën të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes.

Kështu, nenin 19 i DUDNJ përcakton të drejtën themelore të lirisë së shprehjes: Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, gjë që nënkupton të drejtën për të mos u prekur për shkak të opinionëve të tij si dhe të drejtën për të kërkuar, për të marrë dhe për të përhapur informata dhe ide me çfarëdo mjeti të mundshëm dhe pavarësisht nga kufijtë.<sup>9</sup>

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), një marrëveshje zyrtare ligjore detyruese, garanton të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes gjithashtu në nenin 19 përcakton që: “Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje. 2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose meçdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij. 3. Ushtimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.”<sup>10</sup>

---

<sup>8</sup>E drejta e informimit në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; Maeve McDonagh, 2013 <http://www.corteidh.or.cr/tablas/r30698.pdf>

<sup>9</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut [http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/aln.pdf](http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf)

<sup>10</sup>Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/ACovenantCivilPoliticalRights.pdf>

Liria e shprehjes garantohet, gjithashtu, nga KEDNJ në nenin 10: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Përveç dokumenteve të sipërpërmendur, e drejta e informimit gjendet në një sërë rezolutash, komentesh dhe instrumentesh të tjera të së drejtës ndërkombëtare. Një dokument i cili gjithashtu vlen të përmendet në mënyrë të veç është Konventa e Këshillit të Europës mbi aksesin në informacion në dokumente zyrtare.<sup>11</sup>

### **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara<sup>12</sup>**

Liria e shprehjes dhe mendimit, si një e drejtë themelore dhe element i demokracisë i cili sikurse theksohet dhe në kapitujt pararendës është i mbrojtur në Konventa të ndryshme të OKB-së. Formulimi i nenit 21 të KDPAK është një përpjekje për t’a përputhur apo harmonizuar atë me nenin 19 të KDCP. Qartësisht ky nen ka një lidhje të pashmangshme me aksesueshmërinë, e cila garantohet në nenin 9 të KDPAK. Shihet gjithashtu një lidhje e qartë me nenin 2 të KDPAK dhe konkretisht me "Komunikimin", i cili përfshin gjuhët, shfaqjen e tekstit, Braille, komunikimin me prekje, printime të mëdha, multimediale të arritshme, si dhe shkrim, audio, gjuhë të thjeshtë, mjetet dhe formatet e komunikimit, duke përfshirë teknologjinë e qasshme të informacionit dhe komunikimit.<sup>13</sup>

---

<sup>11</sup><https://rm.coe.int/1680084826>

<sup>12</sup>Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara  
[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf)

<sup>13</sup>Përmbledhur nga Manuali për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara: Të Kuptuarit e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, faqe 46, 47; Marianne Schulz, 2010

## Neni 21

### **“Liria e të shprehurit dhe mendimit, dhe mundësimi i informacionit”**

*Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të të shprehurit dhe mendimit, përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacionin dhe idetë në baza të barabarta me të tjerët dhe nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit sipas zgjedhjes së tyre, siç përcaktohen në nenin 2 të kësaj konvente, si më poshtë: a) Sigurimin e informacionit të synuar për publikun e gjerë ndaj personave me aftësi të kufizuara në formate dhe teknologji të realizueshme e të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar në kohën e duhur dhe pa kosto shtesë; b) Pranimin dhe lehtësimin e përdorimit të gjuhës së shenjave, Braille, komunikimit shtesë dhe alternativ dhe e të gjitha mjeteve, mënyrave dhe formave të tjera të komunikimit të realizueshme sipas zgjedhjes së personave me aftësi të kufizuara në ndërveprimet zyrtare; c) Nxitjen e subjekteve private që sigurojnë shërbime për publikun e gjerë, përfshirë dhe internetin, që të sigurojnë informacion dhe shërbime në formate të realizueshme dhe të përdorshme për personat me aftësi të kufizuara; d) Inkurajimin e masmedias, përfshirë dhe sigurimin e informacionit nëpërmjet internetit, për t'i bërë shërbimet e tyre të mundshme për personat me aftësi të kufizuara; e) Njohjen dhe promovimin e përdorimit të gjuhës së shenjave.*

#### IV. LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE AFTËSIA E KUFIZUAR

##### Ligji për të Drejtën e Informimit<sup>14</sup>

**Ligji Nr. 119/2014 Për të Drejtën e Informimit** rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

Ligji për të drejtën e informimit nuk përmban dispozita të veçanta, të cilat rregullojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë informacionin për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë në nenin...parashikohet që “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.” Megjithëse nuk e kemi informacionin nëse ky nen ka pasur parasysh forma apo formate edhe në kontekstin e aftësive të kufizuara, qartësisht qëllimi është ai që personat të kenë akses të plotë në një formë apo format të tillë që e mundëson aksesin e plotë. Gjithashtu, i referohemi përkufizimeve, sipas të cilave “Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Duke qënë se ligji është miratuar pas ratifikimit të KDPAK-së nga shteti Shqiptar, është një mundësi e humbur mospërfshirja e disa dispozitave që rregullojnë çështjen e aksesueshmërisë së informacionit edhe për personat me aftësi të kufizuara, megjithëse sikurse u theksua më lart, çështja mbulohet nga klauzolat e përgjithshme të mosdiskriminimit të nënkuptuara në këtë ligj.

Një tjetër ligj i cili vlen të përmendet, është Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara, ligj ky i cili është thelbësor në sigurimin e aksesueshmërisë edhe në të drejtën e informimit. Edhe pse do të ishte e preferueshme dhe efikase përfshirja e të

---

<sup>14</sup>Ligji për të Drejtën e Informimit Numër 199/2014

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2014/PDF-2014/160-2014.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/160-2014.pdf)



paktën një neni që mbulon çështjen e aksesueshmërisë në ligjin për të drejtën e informimit dhe është e rekomandueshme që në ndërhyrje të ardhshme në ligj, ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë apo KDPAK e rregullojnë çështjen në fjalë.

### **Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara Nr. 93/2014<sup>15</sup>.**

Qëllimi kryesor i ligjit, sikurse shprehet dhe neni 1 i tij është të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe nga ana tjetër *të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara.* Duke u nisur edhe nga vetë emërtimi i ligjit, aksesueshmëria luan një rol qendror në këtë ligj për përfshirjen dhe garantimin e të drejtave, sikurse rezulton edhe në qëllimin e ligjit: *“...në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara...”*

Ligji është përpjekur në mënyrë maksimale, për aq sa është e mundur të përkufizojë termin ‘aksesueshmëri’, një term të cilin KDPAK vetë nuk e ka përkufizuar për arsye të kompleksitetit dhe dinamikës gjithmonë në zhvillim që ai paraqet.

“Aksesueshmëri” sipas ligjit është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.

“Pengesat” nënkuptojnë:

- a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;
- b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar;
- c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;
- ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

Neni 19 i ligjit parashikon qëkry ligj, ligje të tjera dhe aktet nënligjore përkatëse, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht me të drejtat dhe përfitimet e posaçme të personave me aftësi të kufizuar është i disponueshëm në format të aksesueshëm, i cili është

---

<sup>15</sup>Ligji është miratuar më datë 24.07.2014 dhe i botuar ne Fletoren Zyrtare numër 135, më datë 28 Gusht 2014 [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf)

printimi dhe botimi i teksteve në Braille, printim me shkronjë të madhe, në gjuhë të thjeshtuar, të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji për të drejtën e informimit, mund të konsiderohet si një ligj që lidhet me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe si i tillë, duhet botuar edhe në formatet e kërkuara nga ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë.

Neni përmban një sërë dispozitash të cilat patjetër aplikohen për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara. Sfida kryesore mbetet çështja e aksesueshmërisë së informacionit për personat me aftësi të kufizuara. Mosrealizimi i aksesueshmërisë sjell vështirësi në realizimin e të drejtës për informim.

**Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”<sup>16</sup>** rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ky ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimarrëse nga organet publik. Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik.

Edhe ky ligj, sikurse Ligji për të Drejtën e Informimit nuk përmban parashikime specifike për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Në nenin 13 të këtij ligji, aksesimi në dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me projektaktin sigurohet edhe sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit. Sigurisht, që aksesueshmëria duhet garantuar në të gjitha procedurat e parashikuara në këtë ligj. Këtu, sikurse edhe në ligjin e sipërdiskutuar, situata vështirësohet për shkak të një mungese të theksuar të aksesueshmërisë në institucione, në terma fizikë dhe proceduralë. Mosnjohja dhe moszbatimi i legjislacionit që rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë aksesueshmërinë, bën që edhe ligji për njoftimin dhe konsultimin publik të bëhet i paaksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara. Këtu sjellim si shembull institucionet shtetërore të cilat edhe kur realizojnë të gjitha detyrimet në përputhje me ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, nuk ofrojnë akses fizik për personat me aftësi të

---

<sup>16</sup>Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik Numër 146/2014

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2014/PDF-2014/178-2014.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/178-2014.pdf)

kufizuara. Për rrjedhojë, një pjesë e personave me aftësi të kufizuara nuk mund të përfshihen në fazat e konsultimit, por edhe nëse arrijnë të përfshihen, përfshirja është e paplotë dhe jo në kushte të barabarta më të gjitha palët e intesuarra pjesëmarrëse. I njëjti shembull replikohet edhe për llojet e tjera të aftësisë së kufizuar, si për shembull personat që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim, të cilëve nuk u sigurohen formatet Braille apo shkrim i zmadhuar gjatë proceseve të konsultimit.

## **V. ZBATIMI I LEGJISLACIONIT MBI TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE KOMUNITETI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

### **Ligji për të drejtën e informimit**

Nga të dhënat e përftuara rezulton që komuniteti i personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri nuk njeh Ligjin për të Drejtën e Informimit. Një shumicë prej rreth 54% personash (n=59) deklaroi që nuk ka dëgjuar për ligjin për informimin. Pjesa e cila deklaroi që kishte dëgjuar, në 86% (n=44) të rasteve haste vështirësi për të formuluar qëllimin dhe apo aspekte kryesore të ligjit megjithëse në mënyrë shumë të përgjithshme e njihnin atë. Ndërsa pjesa tjetër prej rreth 14 % (n=7) nuk ishin në gjendje të përgjigjeshin në lidhje me qëllimin e përgjithshëm të tij.

Vetëm rreth 27%(n=30) e të intervistuarve me aftësi të kufizuara deklaruan që i ishin drejtuar me kërkesë zyrtare (me shkrim, e-mail) autoriteteve publike (pushtet qendror, lokal, administratës publike) për të kërkuar informacion. Nga këta persona, 56 % (n=17) deklaruan që kishin marrë informacionin e kërkuar brenda afatit kohor të parashikuar në ligj, pra vetëm pak më shumë se gjysma. Ndërsa në një rast kërkesa sapo ishte dërguar.

Kërkesën e dërguar, 26 % (n=8) e kishin përgatitur vetë, ndërkohë që pjesa tjetër ishte asistuar nga të afërm apo të njohur. Disa nga personat me aftësi të kufizuara deklarojnë që: "...kanë nevojë për ndihmë për të hartuar një kërkesë..."ndërsa të tjerë deklarojnë që"...edhe pse mundem ta hartoj vetë, ndihem më i sigurtë me ndihmën e të tjerëve".

Gjatë intervistimeve vihej re një hezitim për dërgimin e kërkesave në mënyrë zyrtare në institucionet publike, hezitim i cili lidhej kryesisht me mungesën e besimit të marrjes së informacionit në rrugë zyrtare. Personat e intervistuar me aftësi të kufizuara shprehën që e kanë më të lehtë të përfaqësohen nga të tretë në institucionet publike për shkak të mungesës së aksesueshmërisë ose zgjedhnin rrugë jozyrtare të marrjes së informacionit pasi rezulton më e shpejtë.

Disa prej tyre deklaruan që: "Personat me aftësi të kufizuara nuk ka njohje, nuk kanë para". Disa të tjerë, që: "Ata janë të izoluar e për rrjedhojë nuk kanë njohje". Ajo çka vihet re është që të drejtën për t'u informuar një pjesë e personave me aftësi të kufizuara e lidhin me njohjet në institucione. Në fakt, të pyetur në lidhje me marrjen e informacionin në rrugë jozyrtare jashtë

ambienteve të institucioneve apo në formatet e parashikuara në ligj, 45% (n=50) u përgjigj që e merrnin në një formë të tillë, duke mos përdorur rrugët zyrtare (në ambientet e institucioneve në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes e-mailit, internetit ose me shkresë zyrtare) të cilat mund të jenë më gjata dhe më të lodhshme për ata. Një pjesë tjetër e personave deklaroi që është faj i vetë komunitetit që nuk kërkon realizimin e të drejtave në formatet e parashikuara në ligj.

Personat pohojnë që “rruga e shkurtër” dhe më e shpejtë është ajo e kontaktimit me punonjës të administratës publike me telefon, përmes të tretëve ose jo në institucione, prandaj deklarojnë që informacionin shpeshherë e marrin në rrugë joformale apo jozyrtare, dhe shpeshherë ky nuk është i plotë dhe nuk ka mundësi për të ndjekur më pas rrugën për plotësimin apo saktësimin e tij. Edhe nga ky numër i vogël që është drejtuar me shkrim ose e-mail, vetëm 56% (n=17) kanë marrë përgjigje. Në asnjë prej rasteve përgjigjet nuk kanë qënë në formate të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Këtu marrim shkas, t’i referohemi edhe raportit të monitorimit të realizuar nga FSHDPAK “Zbatimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara”, nga i cili rezultoi që ka një nivel të ulët të zbatimit të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Ky vendim, ndër të tjera rregullon pikërisht edhe aksesin në informacion apo në proceset e konsultimit.

Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara nuk e njeh mjaftueshëm vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Për pasojë, në shumë pak raste kur i është drejtuar institucioneve publike për informacion apo për konsultim, nuk ka kërkuar formate apo aksesueshmëri për aftësinë e kufizuar. Rezulton që vetëm në x% raste (n=3). Disa nga institucionet publike deklarojnë që kjo ka qënë edhe një nga arsyet sepse ato nuk kanë marrë masa për realizimin e aksesueshmërisë në të gjithë dimensionin e saj sipas VKM-së të sipërcituar. Sigurisht, që ato janë të ndërgjegjësuar mbi faktin që detyrimet ligjore mbeten të tilla, pavarësisht faktit nëse personat me aftësi të kufizuara kanë apo jo kontakte me këto institucione.

Vetëm në pesë raste nga rastet e personave me aftësi të kufizuara të intervistuar ata i janë drejtuar me kërkesë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personave dhe të Drejtës së Informimit. Pesë rastet deklarojnë që nuk i kanë ndjekur më tej kërkesat e tyre.

Vetëm në tre nga rastet ato njohin koordinatorët për të drejtën e informimit në institucionet me të cilët kanë ndërvepruar ata apo të afërm të tyre.

Në pesë raste kanë përdorur programet e transparencës (kryesisht faqet e internetit të institucioneve) për të marrë informacionin që kërkonin. Në këto raste kanë deklaruar që kanë hasur vështirësi me gjetjen e informacionit në faqet e internetit, pasi faqet në asnjë rast nuk ishin të përshtatura.

Nga njëra anë konstatohet një nivel i ulët të njohjes së të drejtave që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit dhe ai i njoftimi dhe konsultimit publik, e për rrjedhojë mospërdorim i mjeteve që ofrojnë këto dy ligje, ndërsa nga ana tjetër, janë autoritetet shtetërore të cilat nuk zbatojnë në mënyrë të plotë detyrimet që i janë vendosur atyre nga legjislacioni për aksesueshmërinë.

Përsa i përket Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, konstatojmë, që edhe pse ky ligj është miratuar në të njëjtën kohë me ligjin e ri për informimin, njihet më pak. Rreth 72% (n=80) e personave të intervistuar deklarojnë që nuk dinë që ekziston një ligj të tillë. Një pjesë e vogël e tyre, 10% (n=8) njohin në mënyrë të përgjithshme qëllimin e ligjit dhe detyrimet që kanë institucionet publike. Pjesa tjetër nuk arrin të shprehë qëllimin e ligjit apo elemente të tjera të tij. 10% (n=8) e tyre kanë marrë pjesë në konsultime publike të zhvilluara në nivel lokal dhe qendror. Njoftimin kryesisht e kanë marrë në format elektronik. Nga tetë pjesëmarrësit në konsultim, vetëm dy janë ftuar para hartimit të projekt-aktit, katër pasi është hartuar projektakti i parë dhe dy të tjerë në të dy fazat. Vetëm tre nga këto raste kanë dërguar rekomandime në formë zyrtare institucionit i cili ka zhvilluar konsultimin. Gjysma e personave shprehen që nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për të përgatitur dhe dërguar rekomandime.

Në të gjitha rastet personat konstatuan që aksesueshmëria ka qënë e munguar për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara. Megjithëse pranojnë që ka pasur përmirësime në drejtim të garantimit të saj, ata pohojnë që nuk zbatohen standardet dhe aksesueshmëria edhe në rastet kur garantohet, është gjithmonë e pjesshme. Në tre raste, të pyetur a janë ndihmuar nga stafet e institucioneve gjatë proceseve të konsultimit, ata u përgjigjen pozitivisht.

Në lidhje me procedurat e ndjekura në rastet kur rekomandimet e tyre nuk janë marrë parasysh nga institucionet, në asnjë rast ata nuk kanë ndjekur procedurën e parashikuar në Ligjin për

Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe deklarojnë që nuk kanë marrë sqarime mbi arsyet e refuzimit të rekomandimeve ose mospërfshirjes së tyre në projektet përfundimtare.

Nga analiza e dy ligjeve kryesore, ai i informimit dhe konsultimit publik, rezulton që ato janë ligje të cilat nuk përfshijnë në dispozitat e tyre personat me aftësi të kufizuara. Sigurisht, që duke u bazuar në parimet e përgjithshme, siç është ai mosdiskriminimit apo gjithëpërfshirjes përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuara por niveli i mbrojtjes dhe përfshirjes së tyre vetëm duke u bazuar mbi këto parime të përgjithshme rezulton të jetë i pamjaftueshëm. Rekomandimi kryesor, është që gjatë ndërhyrjeve të mundshme në këto dy ligje, të përfshihen shprehimisht edhe koncepte si aksesueshmëria, përshtatja e arsyeshme apo personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Legjislacioni i cili garanton aksesueshmërimë është një legjislacion i plotë dhe i avancuar, i cili natyrshëm zbatohet edhe në të drejtën e informimit dhe njoftimit e konsultimit publik. Nevojitet që autoritetet publike përgjegjëse për dhënien e informacionit t'i referohen në mënyrë të vazhdueshme këtij legjislacioni. Ndërhyrjet legislative të përmendura më sipër në kuadrin e rekomandimeve, mund të realizohen edhe përmes referimit në legjislacionin mbi aksesueshmërisë në dy ligjet e mësipërme. Në çdo rast është e domosdoshme që autoritetet publike, përveç njohjes së ligjeve të përgjithshme të njohin dhe të zbatojnë legjislacionin e posaçëm që rregullon aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

## VII. REKOMANDIME & KONKLUSIONE

Bazuar në rezultatet e këtij raporti, një nga rekomandimet e pra ka të bëjë me informimin e personave me aftësi të kufizuara mbi legjislacionin që i garanton atyre, sikurse të gjithëve, të drejtën për t'u informuar dhe për t'u konsultuar.

Kjo e drejtë, sikurse rezulton edhe nga diskutimi i mësipërm, është një e drejtë e cila lidhet ngushtësisht me të drejtën për aksesueshmëri<sup>17</sup>. Pa akses, personat me aftësi të kufizuara nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për informim dhe konsultim publik.

- Natyrshëm, një nga rekomandimet e këtij raporti ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturës fizike, të aksesit të personave me aftësi të kufizuara por këtu një kuptim themelor ndërmerr aksesueshmëria që nevojitet të sigurohet në komunikim dhe në informacion;
- Rekomandohet që informacioni që shpërndahe nga të gjitha institucionet për publikun e gjerë, si detyrim i drejtëpërdrejtë nga ligji për informimin, të jetë i përshtatur edhe për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve publike përkundrejt personave me aftësi të kufizuara janë të qarta në legjislacionin e sipërpërmendur që rregullon aksesueshmërinë. Ky legjislacion akoma nuk njihet nga institucionet;
- Rekomandojmë trajnime të stafit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personave dhe të Drejtën e Informimit në lidhje me aksesueshmërinë<sup>18</sup> për personat me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, institucionet të cilat kryejnë konsultime me publikun në lidhje me çështjet e parashikuara në Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, gjithashtu nuk njohin problemet që hasin personat me aftësi të kufizuar për të kapërcyer barierrat e

---

<sup>17</sup>Këtu përdoret terminologjia e Vendimit të Këshillit të Ministrave Numër nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

<sup>18</sup>Raport monitorimi “Zbatimi i VKM-së Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, ADRF 2017.



për pasojë masat që ato marrin për konsultimin me personat me aftësi të kufizuara, nuk janë të përshtatshme për aftësitë e kufizuara. Megjithatë u vunë re hapa pozitivë në përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në proceset e informimit dhe konsultimit, ato mbetet të pamjaftueshme. Ishte pozitiv fakti që KDI ka marrë disa masa në lehtësimin e dhënies së informacionit nga personat me aftësi të kufizuara, si lehtësimi financiar apo disa hapa për sigurimin e aksesueshmërisë. Megjithatë vendimi i cili rregullon çështjen e aksesueshmërisë nuk njihet nga ky institucion;

- Rekomandohen trajnime dhe seanca informimi me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, kujdestarë dhe familjarë të tyre mbi legjislacionin për informimin dhe konsultimin publik. Rezultatet e monitorimit tregojnë që ligjet dhe të drejtat nuk njihen nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, sikurse edhe nga institucionet që kanë detyrimin për të siguruar aksesueshmërinë. Në këtë kontekst, është e qartë nevoja e menjëhershme për njohjen e të palëve me legjislacionin, detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga ai. Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara nevojitet të njihet me ligjet dhe të drejtat që ata kanë. Është e nevojshme gjithashtu që ata të shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat që i ofrohen nga ligjet, por kjo mund të ndodhë vetëm pas njohjes së përmbajtjes së këtyre ligjeve. Kjo është një nga mënyrat për nxitjen e zbatimit të ligjeve dhe për rritjen e besimit në komunitet, i cili sikurse rezulton nga raporti është në nivel të ulët ndër personat me aftësi të kufizuara të intervistuar;
- Institucionet rekomandohet që të fillojnë të marrin masa graduale për sigurimin e informacionit të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara, duke filluar nga botimi i ligjeve bazë në formate të përshtatura, prodhimi i disa informacioneve në versionet e përshtatura për persona të verbër apo me probleme në shikim, prodhimin e informacioni përmes gjuhës së shenjave në faqet e internetit apo në zyrat ku ofrojnë shërbime, informacion me gjuhë të thjeshtuar, i cili i shërben personave me aftësi të kufizuara në sferën e intelektit;

- Rekomandohen gjithashtu përmirësime në dy ligjet e diskutuara më lart. Këto ligje nevojitet të kenë parashikime specifike për aftësinë e kufizuar, duke mundësuar zbatimin e tyre edhe për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara.